



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:081937  
Datë: 03.04.2024  
Numri i dokumentit: 05628787

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.11/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, (në Objektivin e Gjykatës në Mitrovicë-Veri), kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët, Xhemajl Jusufi dhe Genc Hasani, me procesmbajtësen Edita Kelmendi, në çështjen penale kundër të pandehurit P.M, për shkak të veprës penale; Rastet e rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes nga neni 256 par.1 lidhur me nenin 255 par.3 e lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës (më tej KPK-së), sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, PP.nr.263/2009 dt.09.09.2009. Prokuroria e ka ri kualifikuar në veprën penale, në Grabitja nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 sipas Kodit Penal të Kosovës. Në këtë çështje penale është mbajtur shqyrtimi gjyqësor, seanca ka qenë të hapura për publikun dhe në prezencën e palëve; prokurorit të shtetit në PTH-Mitrovicë, Fetije Bajrami, të pandehurit P.M, mbrojtësit të tij, av.Gani Rexha dhe në mungesë të të dëmtuarave S.... dhe N.M. Shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar më 04.03.2024 të njëjtën ditë është shpall publikisht aktgjykimin, ndërsa më 03.04.2024 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

I pandehuri;

P.M nga i ati ....., e ëma Sh....., e vajzërisë K....., i lindur më dt..... në M....., me vendbanim në S..... me adresën “.....”, me numër personal: ..... sipas letërnjoftimit s....., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon në një fabrikë si punëtor i makinerisë në S....., i gjendjes së mesme ekonomike;

Në mbështetje të nenit 363 par.1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;

## LIROHET NGA AKUZA

Nuk është vërtetuar se;

Më datë 14.06.2009 rreth orës 23:45 minuta në shtëpinë e të dëmtuarës S.M në fsh.....- V....., të njëjtit pas një marrëveshje paraprake dhe ndarjes së detyrave si grup i armatosur së bashku edhe me të miturin A.I me qëllim që vetit t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës dhe kërcënimin me armë nga e dëmtuara kanë marrë sendet e luajtshme në atë mënyrë që, i akuzuari P.M ka siguruar se në shtëpinë e të dëmtuarës nuk gjendet bashkëshorti i saj, N..... dhe është siguruar që e dëmtuara posedon një sasi të madhe të stolive të arit i ka njoftuar të akuzuarit M.H dhe B.M dhe të miturin A.I, të cilët të maskuar dhe të armatosur me armë imituese së pari kanë trokite në derë ku i mitur A.I është paraqitur kinse po kërkojnë bashkëshortin e të dëmtuarës N.M për të blerë një kompjuter dhe posa e dëmtuara S..... ka dal, të akuzuarit M.H dhe B.M, e sulmojnë duke ia lidhur duart dhe gojën me shirit ngjitës të njëjtin veprim e ndërmarrin edhe ndaj fëmijëve të saj B....., A..... dhe A..... Pastaj, kanë kërkuar që e njëjta t'ua jap arin dhe të hollat ku të dyshuarit B.....e M.....të dëmtuarën e dërgojnë në dhomën e fjetjes ku ishte ari, ndërsa i mituri A.I ka qëndruar duke i ruajtur fëmijët dhe pasi që kanë e marrin arin janë larguar nga dritarja e pasme e shtëpisë ku kanë marr arin në vlerë prej 2,000 euro, të cilin më vonë e kanë shitur në një argjendari në M....., kurse e dëmtuara pas largimit të tyre ka arrit që ta largoj ngjitësin nga duart dhe nga goja pastaj edhe nga fëmijët dhe rastin e ka lajmëruar në polici.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale; Grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës.
- Të dëmtuarit S..... dhe N.M për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.
- I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e procedurës mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## A r s y e t i m

- Aktakuza:

Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën, PP.nr.263/09, e datës 09.09.2009, kundër të pandehurve; M.H, B.M dhe P.M, për veprën penale, Rastet e rënda të

vjedhjes grabitqare apo grabitjes nga neni 256 par.1 lidhur me nenin 255 par.3 me par 1 të KPK-së. Kjo akuzë është dorëzuar në gjykate më 09.09.2009.

- Kompetenca;

Sipas nenit 1, paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Sipas nenit 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra e pretenduar penale ka ndodhur dhe është kryer në regjionin e V....., dhe rrjedhimisht, bien brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 22, paragrafi 1, i KPP-së, veprat penale të kësaj natyre bien në juridiksionin e Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore. Prandaj, e tërë lënda është gjykuar nga Departamenti për Krime të Rënda.

- Rrjedha e procedurës:

Ndaj të pandehurve, M.H dhe B.M, procedura penale ka përfunduar, të njëjtit janë shpall fajtor dhe dënuar për këtë rast me aktgjykim të formës së prerë.

Ndërsa, sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.5/2010, dt.17.01.2019, procedura penale është veçuar ndaj të pandehurit P.M, pasi që i pandehuri për një kohë të gjatë ka qëndruar në arrati. Kështu që, shqyrtimi gjyqësor dhe çështja penale është zhvilluar vetëm për të pandehurin P.M.

- Shqyrtimi gjyqësor;

Në këtë çështje penale shqyrtimi gjyqësor është mbajtur më 04 mars 2024.

- Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor;

Shqyrtimi gjyqësor kanë qenë i hapur për publikun. Palët nuk kanë paraqitur vërejtje lidhur me publicitetin e shqyrtimit gjyqësor.

- Gjuha e përdorur në shqyrtimin gjyqësor;

Seanca e shqyrtimit gjyqësor është mbajtur dhe zhvilluar në gjuhën shqipe.

- Regjistrimi i seancave;

Rrjedha e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale është regjistruar në procesverbal. Palët nuk kanë paraqitur asnjë vërejtje mbi përmbajtjen e procesverbalit. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, palëve u është dhënë nga një kopje e procesverbalit. Shqyrtimit gjyqësor nuk është regjistruar me audio dhe video, pasi që kanë munguar pajisjet e nevojshme për incizime të tilla, por regjistrimi është bërë në procesverbal me shkrim.

- Siguria në seancat e shqyrtimit gjyqësor;

Gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është shënuar asnjë incident për cenimin e sigurisë për palët apo pjesëmarrësit tjerë në procedurë.

- Prezenca e palëve në shqyrtim gjyqësor;

Në shqyrtimin gjyqësor kanë prezantuar prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë, Fetije Bajrami, i pandehuri P.M, mbrojtësi i tij, av.Gani Rexha. Kanë munguar të dëmtuarit S.....dhe N.M, përkundër që është bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar prezencën e tyre. Sipas raporteve zyrtare nga policia rezulton se të dëmtuarit nuk jetojnë në Kosovë, por jetojnë diku në perëndim dhe adresa e tyre nuk dihet.

Rikujtojmë se gjatë shqyrtimit fillestar, prokurori i rastit e ka ndryshuar akuzën në raport me cilësimin juridike të veprës penale, ashtu që, në ri cilësim të pandehurin e ka akuzuar për veprën penale; Grabitja nga neni 255 paragrafi .3 lidhur me paragrafin .1 sipas Kodit Penal të Kosovës.

- Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor;

Në cilësi të provës janë administruar, provat e propozuar në aktakuzë nga prokuroria e shtetit në PTH në Mitrovicë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 03.03.2024, janë dëgjuar dëshmitarët, M.M dhe H.M

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata në mbështetje të nenit 335 par.1 nën par 1.1 e 1.3 të KPP-së, dhe me pëlqimin e palëve, ka marr vendim duke i lexuar;

- Deklaratat e dëshmitares S.M që ka dhënë në policinë e Kosovës më dt.15.06. 2009 dhe më 14.06.2009.

- Deklaratën e dëshmitarit N.M, që ka dhënë më dt.13.08.2009 në Prokurorinë Publike të Qarkut në Mitrovicë.
- Deklaratën e dëshmitarit R.B që ka dhënë më dt.23.07.2009 në Prokurorinë Publike të Qarkut në Mitrovicë.
- Deklaratën e dëshmitarit B.M që ka dhënë më dt.17.01.2019 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në shqyrtimin gjyqësor në të njëjtën çështjen penale që është zhvilluar kundër të pandehurve M.H dhe B.M.
- Deklaratën e V.B, që ka dhënë më dt.17.01.2019 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në shqyrtimin gjyqësor në të njëjtën çështjen penale që është zhvilluar kundër të pandehurve M.H dhe B.M.

- Administrimi i provave materiale;

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.03.2024, në cilësi të provave materiale janë administruar provat materiale, si vijon;

- Raporti Identifikues i Forenzikut i dt.15.06.2009, nga Policia e Kosovës.
- Raporti mbi shikimin e vendit të ngjarjes i dt.15.06.2009, Policia e Kosovës –Stacioni Policor në Vushtrri.
- Foto-dokumentacioni mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes në 20 fotografi, përpiluar nga Policia e Kosovës –Stacioni Policor në Vushtrri.
- Lista e gjërave të sekuestruara dt.15.07.2009, nga Policia e Kosovës –Stacioni Policor në Vushtrri.
- Raporti mbi ekzaminimin daktiloskopik nga Laboratori Qendror i Kriminalistikës, dt.04.08.2009.
- Lista e gjërave të sekuestruara.

- Marrja në pyetje e të pandehurit:

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.03.2024, i pandehuri P.M ka paraqitur mbrojtjen e tij.

- Fjala përfundimtare;

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.03.2024, palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

- Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor:

Më 4 mars 2024, Gjykata e ka shpallur të përfunduar shqyrtimin gjyqësor.

- Shpallja publike e aktgjykimit;

Gjykata më datën 04.03.2024, në këtë çështje e ka shpall publikisht aktgjykimin.

- Përmbajtja e fjalës përfundimtare të palëve:

Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë, Fetije Bajrami, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, qëndron pranë aktakuzës se ngritur ndaj të pandehurit P.M, për veprën penale Grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së. Sipas saj, i pandehuri ka kryer veprën penale dhe kjo vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarëve, S.M, pjesërisht nga deklaratat e dëshmitarëve M.M, H.M dhe R.B, si dhe deklaratat e të pandehurit dhënë në polici, i cili menjëherë pas rastit në deklaratën në polici ka theksuar se sipas marrëveshjes është takuar me të pandehurit B.M dhe M.H, dhe i'u ka treguar se axha i tij, N.M nuk gjendet në shtëpi, dhe dy të pandehurit tjerë, pas marrëveshjes me të pandehurit P.M, kanë shkuar në shtëpinë e të dëmtuarës S.M, bashkëshortja e N.M, kanë kryer veprën penale të grabitjes duke i'a marr të gjithë arin e saj. Ndërsa i pandehuri P.M, të nesërmen është interesuar dhe është takuar me të pandehurit tjerë, ku pas shitjes së arit të pandehurit Petrit ia japin 100 euro. Krejt në fund, propozon që i pandehuri të shpallet fajtor të dënohet sipas ligjit, duke marr për bazë dhe vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësues në këtë rast.

Mbrojtësi i të pandehuri P.M, av.Gani Rexha në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat që janë nxjerr gjatë shqyrtimit gjyqësor, në asnjë mënyrë nuk është vërtetuar se P.M ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Sipas mbrojtësit, të gjithë dëshmitarët e dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, deklaratat e të dëmtuarve N....e S.M dhe deklaratat e dëshmitarëve të cilat u lexuan në shqyrtimin gjyqësor, në asnjë mënyrë nuk është vërtetuar se i pandehuri ka marr pjesë në kryerjen e kësaj veprë penale apo ka përfituar në çfarëdo mënyrë nga kryerja e kësaj veprë penale. Tutje mbrojtësi ka shtuar se e vetmja provë që për mbrojtjen është e kundërligjshme, është dëshmia e tij e dhënë në polici më dt.26.06.2009 e cila deklaratë është e trilluar dhe ashtu siç u theksoj i pandehuri këtë deklaratë e ka e dhënë nën tryshnin e përdorimit të forcës dhe ky fakt dëshmohet se më parë i mbrojturi im është marr në pyetje si dëshmitar ku nuk ka pranuar kryerjen e veprës penale e më pastaj është marr në pyetje si i pandehur, ku me përdorimin e forcës është detyruar ta pranoj se e ka kryer këtë vepër penale.

Shton se sipas nenit 262 par.1 të KPP-së, dëshmia e dhënë e të pandehurit në polici, mund të përdoret si provë nëse përkrahet apo mbështetet nga ndonjë provë tjetër materiale. Në rastin konkret asnjë provë e vetme e nxjerr gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e dëshmoj përfshirjen e të pandehurit në këtë vepër penale. Mbrojtësi ka propozuar që i pandehuri të lirohet nga akuza në mungesë të provave.

I pandehuri P.M në fjalën përfundimtare e ka përkrah në tërësi fjalën përfundimtare që ka paraqitur avokati tij, ndërsa nuk ka paraqitur fjalën përfundimtare.

- Faktet e çështjes;

I pakontestueshëm ka qenë fakti se më datë 14.06.2009, rreth orës 23:45 minuta, në fsh.R.....-Komuna e Vushtrrisë, derisa e dëmtuara S.M me fëmijët e saj kanë qenë në shtëpinë e tyre, tre persona, dy prej tyre të maskuar dhe të armatosur, kanë hyrë në shtëpinë e saj dhe nën kërcënimin e përdorimit të forcës me armë imituese e kanë ndarë të dëmtuarën nga fëmijët e saj, me shirit izolues i'a ka lidhur duart, këmbët dhe gojën, të njëjtën mënyrë kanë vepruar edhe me fëmijët e saj, pastaj nën detyrim dhe kërcënim kanë arrit t' ia marrin një sasi të stolive të arit dhe gjësendeve tjera me vlerë të përafërt rreth 2,000 Euro.

Faktet si më lart nuk kanë qenë kontestuar nga palët. Përveç kësaj, faktet e tilla vërtetohen edhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Ky fakt, provohet sipas raporteve të policisë, raportit mbi shikimin e vendit të ngjarjes si dhe foto dokumentacionit që pasqyron vendi ku është kryer grabitja.

Dëshmitarja S.M në dëshminë që ka dhënë në polici e Kosovës më dt.15.06.2009, ka përkrahur se si ka ndodhur e gjithë ngjarja natën kritike. Ajo ka theksuar se natën e ngjarjes ka qenë në shtëpi me fëmijët e saj, ndërsa bashkëshorti i saj ka qenë në punë në ndërrimin e natës. Sipas saj, gjersa po qëndronte në shtëpi, një person ka trokitur në derë dhe e ka kërkuar bashkëshortin e saj dhe pasi e ka hap derën, me forcë kanë hyrë në shtëpi dy persona tjerë të maskuar dhe me armë në dorë. Sipas saj, këta persona ia kishin lidhur duart, gojën dhe këmbët me ngjitës dhe e kanë ndarë nga fëmijët e saj, dhe e kanë vendosur në një dhomë tjetër. Dëshmitarja ka thënë se edhe fëmijët i kanë lidhur me shiritin izolues. Sipas dëshmitares, personat në fjalë e kanë detyruar atë dhe djalin e saj B..... që t'iu tregoj se ku gjenden stolit e

arit, pastaj ia kanë marrë gjithë sasinë e arit dhe janë larguar. Për gjykatën dëshmia e dëshmitares për këto rrethana është plotësisht e besueshme, pasi që përputhet me provat që janë siguruar në këtë rast; me raportin e këqyrjes se vendit të ngjarjes, foto dokumentacionin, dëshminë e dëshmitarit N.M dhe me vërtetimin për sekuestrimin dhe kthimin e sendeve të dëmtuarës. Për më tepër, dëshmia e dëshmitares ka qenë e çartë e kuptueshme, se ka qenë okulare e cila e ka pa dhe përjetuar drejtpërdrejtë ngjarjen.

Faktet e lartcekura, pjesërisht vërtetohen edhe nga dëshmia e dëshmitarit N.M, i cili ka pohuar faktin se natën kritike rreth orës 24:00, një familjar i tij (djalin e tezës) me emrin S.C, e kishte njoftuar se kishte ndodhur një grabitje në shtëpinë e tij. Sipas dëshmitarit, S..... e kishte kuptuar këtë rrethanë, përmes S....., bashkëshortes së të dëmtuarit dhe përmes internetit e kishte njoftuar atë për këtë ngjarje. Dëshmitari më tutje, ka theksuar se menjëherë pas kësaj e kishte njoftuar policinë dhe kur ishte kthyer në shtëpi kishte takuar policinë dhe prokurorin edhe disa familjar të tij. Sipas dëshmitarit, për ngjarjen në detaje e kishte njoftuar bashkëshortja e tij. Për gjykatën dëshmia e këtij dëshmitari është e besueshme, megjithëse ky dëshmitar nuk ka qenë okular por dëshmia e tij, bazohet në informacionin që ka marr nga e dëmtuara-bashkëshortja e tij, dhe dëshmia e tij përputhet me përshkrimin që ka bërë e dëmtuara lidhur me ngjarjen [grabitjen] që ka ndodhur me dt.14.06.2009.

Faktet e lartcekura, pjesërisht vërtetohen edhe nga provat materiale si në vijim; nga raporti i Forenzikës dt.15.06.2009, raporti mbi shqimin e vendit të ngjarje i hartuar nga Policia e Kosovës, dhe foto-dokumentacioni nga vend shikimin sipas të cilave vërtetohet grabitja e stolive të arit kishte ndodhur më dt.14.06.2009, në shtëpinë e të dëmtuarës në fsh-R..... komuna e V..... Sipas këtyre dëshmive përshkruhen hapësirat e brendshme të shtëpisë ku ka ndodhur ngjarja, shihet se janë gjetur një pjesë e shiritave (ngjitësit) që janë përdorur për të lidhur të dëmtuarën dhe fëmijët e saj. Gjithashtu dëshmohet se në vendin e ngjarjes janë gjet disa gjurmë të krimit, siç janë: shirita ngjitës, pranga të plastikës dhe gjësende tjera që tregojnë për sendet që janë përdorë me rasti e grabitjes.

Nuk ka qenë kontestues fakti se natën kritike nën përdorimin e forcës dhe kërcënimit me armë, tre persona që kanë kryer grabitjen ku kanë arritur që të dëmtuarës t'ia marrin një sasi të stolive të arit dhe gjësendeve tjera me vlerë.



Faktet e lartcekura vërtetohen edhe me provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. E dëmtuara si dëshmitare, S.M në dëshminë e saj, ka pohuar se natën kritike personat e tre persona të armatosur, dy të maskuar nën kërcënim dhe me forcë kanë arrit t'ia marrin një sasi të madhe të arit dhe gjësendeve tjera me vlerë. Pjesërisht këtë fakt e pohon edhe bashkëshorti i saj, N.M, ndonëse se dëshmia e tij mbështetet në pohimet e të dëmtuarës S.M. Gjithashtu, sipas vërtetimit mbi sekuestrimin e sendeve dhe dëshmisë së argjendarit V.B, rezulton se më datën 15.06.2009 në argjendarin ku ka punuar e ka blerë një sasi të arit nga i akuzuari B.M, të cilin e ka identifikuar në bazë të fotografive të prezantuar në procesin e njohjes dhe identifikimit të personave dhe sendeve.

Dëshmitari V.B në dëshminë e tij në shqyrtimin e kaluar gjyqësor, ka pranuar se është pronar në lokalin ".....", Mitrovicë. Ai ka pohuar se më dt.15.06.2009, rreth orës 13:00-14:00 e ka blerë ari nga një person që kishte shkuar në lokalin e tij. Arin të cilin e ka blerë kanë qenë; dy unaza të femrave, një zinxhir fyti, një hallhalle dore dhe një qystek (zinxhir i trashë-ari), të gjitha në vlerë prej 850 euro. Dëshmitari ka konfirmuar se në bazë të fotografive e ka identifikuar personin nga i cili e ka blerë arin. Sipas tij, personi nga i cili e ka blerë arin shihet në foton me numër 3 të identifikimi sipas fotoalbumit dhe që në bazë të fotografisë rrjedhë se në atë foto ka qenë i pandehuri B.M.

Ndërsa në bazë të vërtetimit mbi sekuestrimin e sendeve, vërtetohet se policia e ka sekuestruar një sasi të arit në argjendari dhe një sasi tjetër të arit e cila është gjet e fshehur në një pyll në fsh.V....., Komuna e V..... Ku pastaj, gjithë sasia e arit të gjetur i është kthyer dhe dorëzuar të dëmtuarës S.M

Ky fakt vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitares S.M që ka dhënë me dt.15.07.2009, e cila ka konfirmuar se sasia e arit të cilin e ka sekuestruar policia, janë sendet (ari) që i përkasin asaj që është grabitur natën kritike në shtëpinë e saj.

Sipas aktakuzës, aktin e grabitjes e kanë kryer tre persona, dy persona të maskuar dhe një person tjetër i pamaskuar i cili para aktit të grabitjes e kishte kërkuar pronarin e shtëpisë të dëmtuarin N.M.

Gjykata rikujton se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Pn.nr.05/2010 i dt. 24.12.2019, për këtë rast të grabitjes janë shpall fajtor dhe dënuar sipas ligjit të pandehurit, M.H dhe B.M. Ndërkaq, prokuroria e ka identifikuar si të përfshirë drejtpërdrejtë në grabitje edhe të miturin A.I.

- Pretendimet e prokurorisë në aktakuzë në raport me të pandehurin P.M;

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, i pandehuri P.M akuzohet se më dt.14.06.2009 rreth orës 23:45 minuta, në bashkëveprim edhe me të pandehurit M.H, B.M dhe të miturin A.I, në fsh.R.....-Komuna e V....., kanë kryer veprën penale të grabitjes ndaj të dëmtuarës S.M, ashtu që, me përdorimin e forcës, kanosjes dhe përdorimin e armëve imituese, kanë arritur që të dëmtuarës t’ia marrin një sasi të arit një shumë të parave. *Sipas aktakuzës, “i pandehuri P.M akuzohet se i ka informuar të pandehurit tjerë se në shtëpinë e axhës së tij, ka një sasi të arit, gjithashtu se axha i tij, gjendet në punën në ndërrimin e natës”.*

I pandehuri P.M gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka mohuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka shtuar se nuk ka qenë i përfshirë në këtë rast dhe nuk ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësit i të pandehurit P.M, av.Gani Rexha , i ka kundërshtuar pretendimet e prokurorisë me arsyetimin se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Nëse e vështrojmë aktakuzën në raport me veprimet e pretenduar për të pandehurën, vërejmë se mungojnë shpjegimi apo arsyetimi se si prokuroria ka arrit deri te përfundimi për sa i përket përfshirjes së të pandehurit në këtë rast të grabitjes. Në faqen 3-5 në arsyetimit të akuzës, prokuroria nuk i referohet asnjë dëshmie të vetme përmes të cilës mund të vërtetohet fajësia e të pandehurës. Mirëpo në arsyetimin e aktakuzës pretendohet se fajësia e të pandehurit P.M mund të vërtetohet nga deklaratat (dëshmia) e të pandehurit M.H. Mbi këtë bazë mund të konkludojmë se prokuroria akuzën e saj në raport me të pandehurin P.M e mbështet ekskluzivisht në deklaratën e të bashkëpandehurit M.H.

Për sa i përket deklaratës së të pandehurit M.H, Gjykata rikujton se deklaratat e tij nuk është administruar/shqyrtuar si provë gjatë gjykimit kundër të pandehurit P.M. Ndërkaq, sipas nenit

8 dhe 360 të KPP-së, përcaktohet se Gjykata është e obliguar që vendimet e saj t'i merr dhe t'i mbështes vetëm në provat dhe dëshmitë që janë shqyrtuar dhe verifikuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Prandaj, mbi këtë bazë vlerësojmë se në raport me të pandehurin P.M, gjykata nuk mund të referohet apo ta mbështes vendimin në një dëshmi e cila nuk është shqyrtuar gjatë gjyqimit të çështjes penale.

Për më tepër, i pandehuri M.H ka qenë i bashkë akuzuar për të njëjtën çështje penale me të pandehurit tjerë, P.M, B.M dhe të miturin A.I. Prandaj për këto arsye, deklarata apo mbrojtja e tij, nuk mund të shërbej si provë fajësuese në raport me bashkëpandehurit tjerë duke mos përjashtuar të pandehurin P.M.

Gjykata rikujton se sipas nenit 119 par.5 të Kodit të Procedurës Penal, përcaktohet se deklarata e të pandehurit nuk mund të shërbejë si provë në raport me të bashkëpandehurin tjerë, aq më tepër si provë e vetme.

- Shih paragrafin 5 të nenit 119 të KPP-së.

Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë;

*“Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por ato nuk mund të shërbejnë si prova të vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit që i ka dhënë. Deklaratat e të pandehurit të dhëna në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim, nuk mund të shërbejnë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçuar, përveç kur ky Kod në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se deklarata e tillë mund të shërbej si provë”.*

Jo vetëm që dëshmia e të bashkëpandehurit që nuk mund të përdoret si provë në raport me të pandehurin P.M, por i pandehuri M.H s'mund të pyetet as si dëshmitar në këtë rast, përkundër që procedura penale kundër tij ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë. Në këtë drejtim, rikujtojmë se sipas nenit 123 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, përcakton se si dëshmitar nuk mund të ftohet dhe dëgjohet i bashkëpandehuri në një çështje penale të njëjtë, përveç kur i bashkëpandehuri është shpall dëshmitar bashkëpunues.

- Shih nenin 123 të KPP-së.

#### Dëshmitarët e privilegjuar

*1. Si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje:*

*1.1. personi i cili me deklarinimin e vet do të shkelte detyrën e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare ose ushtarake, derisa organi kompetent nuk e liron nga ky detyrim;*

*1.2. mbrojtësi, për atë që i pandehuri ia ka besuar atij në cilësi të mbrojtësit të vet, përveç kur kërkon vetë i pandehuri; dhe*

*1.3. i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët apo e veçuar, përveç kur i bashkëpandehuri është dëshmitar bashkëpunues sipas nenit 231 të këtij Kodi.*

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të pandehurit P.M që ka dhënë në polici, ku ka pohuar se; “natën e ngjarjes i ka takuar M.H dhe B.M, të cilët e kanë pyet se ku gjendet axha i tij?. Sipas tij, ai i ‘u ka treguar të pandehurve se axha i tij nuk gjendet në shtëpia, por në ndërrimin e dytë të punës”. Sipas të pandehurit, B..... dhe M..... i kanë treguar se kanë ndërmend të hynë në shtëpinë e axhës së tij, me qëllim që t’ia marrin arin bashkëshortes së tij, pasi kanë dëgjuar se ka sasi të madhe të arit”. Në këtë deklaratë i pandehuri ka pranuar se të nesërmen ishte takuar M.H dhe B.M, dhe M..... i kishte treguar për rastin dhe i’a kishte dhënë 100€.

Ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor i pandehuri ka mohuar përfshirjen në këtë vepër penale, gjithashtu e ka mohuar fajësinë në raport me akuzën e prokurorisë. I pandehuri gjithashtu e ka kundërshtuar përmbajtjen e deklaratës së tij, që ka dhënë në polici me arsyetimin se deklaratën e ka dhënë nën presion. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, i pandehuri në deklaratën e lartcekur nuk ka pohuar ndonjë fakt fajësues për vetveten. Ai më tepër dëshmon për veprimet e personave tjerë, në këtë rast të pandehurve, M.H dhe B.M. Mbi bazën e deklarimeve të tij nuk mund të provohet se i pandehuri ka qenë i përfshirë në grabitjen e arit në shtëpinë e të dëmtuarve. Sipas deklaratës së tij, rezulton se i pandehuri i’u kishte treguar të pandehurve (M.H dhe B.M) për vendndodhjen e axhës së tij, sepse paraprakisht ata e kishin pyetur të pandehurin për axhën e tij, dhe pastaj i kishin treguar për qëllimin e tyre për të kryer grabitjen në shtëpinë e tij. Prandaj, përgjigja e të pandehurit P..... për vendndodhjen e axhës së tij, në asnjë mënyrë nuk nënkupton se ka bashkëpunuar në këtë krim me të pandehurit, M.H, B.M dhe A.I. Në anë tjetër, rikujtojmë se përgjegjësia penale është individuale dhe jo kolektive që nënkupton se secili përgjigjet për veprimet e tij inkriminuese.

Për më tepër, Gjykata rikujton kufizimet që parashihen me nenin 257 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penal, ku përcakton se; “Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit”.

Neni 257 i KPP-së

Kufizimet e provave;

- 1. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.*
- 2. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit.*
- 3. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.*
- 4. Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.*

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshmitë e dëshmitarëve, M.M, H.M dhe R.B në raport me të pandehurin P.M.

Dëshmitarët M..... dhe H.M, në dëshmitë e tyre të cilat i kanë dhënë në prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor, si dhe dëshmitari R.B, dëshmia e të cilit është lexua në shqyrtimin gjyqësor, kanë theksuar se natën kritike kanë qenë në lokalin e lojërave “Soni play-station” fsh-R....., ku ka qenë edhe i pandehuri B.M. Sipas tyre në lokal kanë shkuar rreth orës 20:00-21:00, ndërsa kanë qëndruar deri pasmesnatës. Dëshmitarët kanë pohuar se i pandehuri B.M, gjatë gjithë kohës ka qëndruar në lokal, derisa e kanë mbyllur lokalin dhe pastaj të gjithë së bashku janë larguar nga aty për në shtëpitë e tyre.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykata, dëshmitë e tre dëshmitarëve si më lart nuk provojnë asnjë fakt fajësues për të pandehurin P.M. Për më tepër, këta dëshmitar nuk kanë qenë okular dhe nuk kanë dhënë dëshmi në polici pas ngjarjes. Dëshmitë e tyre i kanë dhënë vetëm në prokurori,

pasi ka kaluar një kohë relativisht e gjatë pas ngjarje. Dëshmitë e tyre i kanë dhënë me dt.23.07.2009, pothuajse dyzet ditë pas ngjarjes-grabitjes. Gjithashtu gjykata ka pasur parasysh se këta dëshmitar kanë dëshmuar vetëm për një rrethanë, përkatësisht për vendndodhjen e të pandehurit B.M, natën kritike. Pra, dëshmitë e tyre kanë të bëjnë me të pandehurin B.M, çështje e cila ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë. Ndërkaq, lidhur me çështjen e grabitjes, dëshmitarët kanë mohuar se kanë ndonjë informacion se kush e ka kryer grabitjen dhe se për rastin kanë dëgjuar me vonë dhe pasi ka ndodhur ngjarja.

Për sa i përket dëshmimeve të dëshmitarëve S.M, N.M dhe V.B, Gjykata vlerëson se nga dëshmitë e tyre vërtetohen disa fakte të rëndësishme që kanë të bëjnë me veprën penale por që nuk dëshmojnë asnjë fakt fajësues për të pandehurin P.M. Nga dëshmia e dëshmitares S.M, vërtetohet fakti se natën e ngjarjes tre persona, dy prej tyre të maskuar dhe të armatosur, nën kërcënimin e armës dhe me përdorimin e forcës fizike kanë arrit t'ia marrin një sasi të arit dhe gjësendeve tjera me vlerë të përafërt rreth 2,000 Euro. E dëmtuara pohon se kanë qenë tre persona, dy prej tyre të maskuar, megjithatë nuk ka arrit t'i identifikojnë asnjërin prej tyre, përveç se është munduar të përshkruaj njërin prej grabitësve. Ndërkaq, dëshmitarit N.M dëshminë e tij e ka dhënë duke u mbështet në informacionet që ka siguruar pas ngjarjes nga bashkëshortja e tij, S.M Pra, ky dëshmitar nuk ka qenë okular dhe nuk ka qenë prezent natën e ngjarjes në shtëpi kur ka ndodhur grabitja, si rezultat nuk ka pas mundësi ti shohë e as ti identifikojë personat pjesëmarrës në grabitjen që kanë kryer në shtëpinë e tij.

Sa i përket deklaratës së V.B, rikujtojmë se ai ka pohuar se më dt.15.06.2009 rreth orës 13-14, në lokalin e tij "....." e ka blerë një sasi të arit nga një person të cilin e ka identifikuar përmes fotografive. Sipas tij, personi i cili ia kishte ofruar për të blerë arin ka qenë i pandehuri B.M. V.B në asnjë moment nuk e ka fajësuar për këtë rast të pandehurin P.M.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë që ka dhënë në prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmitari B.M. Në dëshminë e tij, ka thënë se për rastin ka dëgjuar në polici të nesërmen rreth orës 16-00, sepse ka punuar në polici. Ndërsa në mbrëmje të po asaj dite, kishte biseduar me vëllain e tij, B.M, që gjatë bisedës i kishte thanë se është i sigurt që grabitjen e ka kryer P.M". Sipas vlerësimeve të kësaj gjykatës, dëshmia e tij nuk mund të ketë ndonjë rëndësi për çështjen penale, sepse ky dëshmitar nuk ka qenë okular, çka do të thotë se nuk ka pas informata të drejtpërdrejt për rastin, por deklaratimet e tij i ka mbështet në informatat që ka marr nga vëllai i

tij, përkatësisht i pandehuri B.M. Dëshmitari ka thënë se një ditë pas ngjarjes në orët e mbrëmjes, kishte biseduar me vëllain e tij, B....., i cili i kishte thënë për personin apo personat e dyshuar për këtë grabitje. Sipas dëshmitarit, të nesërmen i kishte njoftuar policinë për këtë informata, që i bie më dt.16.06.2009. Por bazuar në të dhënat nga shkresat e lëndës rrjedh se më dt.15.06.2009, ishin shpërndarë informatat për personat e dyshuar, ku si person i dyshuar ishte përmendur edhe B.M, vëllai i dëshmitarit B.M. Prandaj, dëshmia e dëshmitarit B.M nuk mund të merret e besueshme, sepse në këtë rast të grabitjes ka qenë i përfshirë edhe vëllai i tij, i pandehuri B.M. Deklarimet e dëshmitarit në raport me të pandehurin P.M, shihen si një përpjekje për të heq vëmendjen apo për të larguar përgjegjësin nga vëllai i tij, dhe bartjen e përgjegjësisë te personat tjerë.

Duke qenë se dëshmia e dëshmitarit B.M, plotësisht mbështet në deklaratimet e të pandehurit Bashkim, i cili në këtë rast është i bashkëpandehur, vlerësojmë se dëshmia e tij s'mund të shërbej dhe as të përdoret si provë fajësuese për të pandehurin P.M.

Në këtë rast, Gjykata nuk ka arrit që të provojë as nivelin më të ulët të dyshimit për të pandehurin sa i përket veprës penale për të cilën akuzohet. Sipas dëshmive të pranueshme nuk mund të dëshmohet se i pandehuri ka marr pjesë apo është përfshirë në këtë rast të grabitjes.

Gjykata i ka vlerësuar edhe dëshmitë materiale të propozuara, sipas këtyre dëshmive vërtetohen faktet në raport me ekzistimin e veprës penale, sendet që janë gjet dhe sekuestruar në vendngjarje, pasqyrimi i tyre në raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, mirëpo asnjë prej provave materiale nuk dëshmon fajësinë apo përfshirja e të pandehuri në këtë rast të grabitjes.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykata, provat e paraqitura dëshmojnë se ka ndodhur një krim, përkatësisht se më datën 14.06.2009 rreth orës 23:45 minuta në shtëpinë e të dëmtuarës, S.M në fsh.R.....-V..... është kryer grabitja me armë, ku tre persona, dy prej tyre të maskuar nën kërcënimin me armë ia kanë marr të dëmtuarës gjithë sasinë e arit që ka poseduar, ashtu siç edhe përshkruhet në aktakuzë. Mirëpo përmes këtyre provave nuk mund të dëshmohet se këtë vepër penale e ka kryer i pandehuri P.M.

Si përfundim Gjykata vlerëson se prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit. Provat të cilat janë paraqitur, janë të zbehta dhe të

pamjaftueshme për të vërtetuar përtej çdo dyshimi fajësinë e tij. Në anën tjetër, nuk mjaftojnë vetëm të dhënat apo indiciet për të provuar fajësinë e një personi të akuzuar, por është e domosdoshme të jetë niveli shumë i lart i të provuarit apo thënë ndryshe të provuarit përtej çdo dyshim ku qartë dhe bindshëm dëshmohet fajësia e të akuzuarit.

- Aspekti ligjore dhe obligimet e prokurorisë;

Gjykata rikujton që sipas nenit 234 par.1 të KPP-së, se prokuroria ka për obligim të ngrisë aktakuzën vetëm në rastet kur ka prova të mjaftueshme për një gjë të tillë që mbështesin dyshimin e bazuar mirë në të kundërtën kanë për obligim që t'i pushojnë hetimet.

Gjykata gjithashtu rikujton se sipas nenit 47 të KPP-së, prokurori i shtetit duhet që gjatë hetimit të veprave penale të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të siguroj që një hetim të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit dhe që mbledhja e provave të mos bëhet në kundërshtim me Kapitullin XVI të këtij kodi. Gjithashtu duke u bazuar në nenin 235 të KPP-së, përcaktohet se; në akuzë duhet të jepen shpjegimet e arsyeshme për ngritjen e akuzës, bazuar në rezultatin e hetimeve dhe provave që i vërtetojnë faktet kryesore. Në rastin konkret, prokuroria nuk ka siguruar prova, pothuajse asnjë provë të vetme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte për të vërtetuar përtej çdo dyshimi fajësinë e të pandehurit.

Gjykata rikujton një parim shumë të rëndësishëm të procedurës penale; "In dubio pro reo", i sanksionuar me nenin 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Sipas këtij parimi përcaktohet se; *"mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij"*.

Andaj në mungesë të provave fajësues, Gjykata vendosi që të pandehurin P.M ta liroj nga akuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.nr.263/2009 dt.09.09.2009, për veprën penale të grabitjes nga nenin 255 par.3 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës.

- Kërkesa pasurore juridike;

Gjykata në përputhje me nenin 462 paragrafi 3 të KPP-së, ka vendos që palët e dëmtuara t'i udhëzoj në kontest të rregull civil për realizimin e kërkesës pasurore- juridike.



- Shpenzimet e procedurës;

Gjykata në përputhje me nenin 453 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendos që ta liroj të pandehurin nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale duke qenë se është liruar në tërësi nga akuza.

Nga ajo që u tha me lart u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.11/2019 dt.03.04.2024

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, pas pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palë.